

KONTABILITETI ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA NË SEKTORIN PUBLIK

Një instrument kyç për qeveritë

Veprimtaria shtetërore zë një pjesë të madhe të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Prandaj është e rëndësishme që fondet dhe mjetet publike të administrohen në mënyrë efektive dhe që qeveritë të japin llogari për administrimin e tyre përpara qytetarëve, përfaqësuesve të tyre, investitorëve dhe palëve të tjera të interesit. Në sektorin privat, kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara ka mbi një shekull që përdoret, ndërsa në sektorin publik metoda parësore e përdorur është kontabiliteti me bazë monetare. Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara po vihet në zbatim gjithnjë e më shumë në sektorin publik, siç theksohet në studime të ndryshme, si Vrojtimi i OECD-së i vitit 2016 mbi llogaritë me të drejta dhe detyrime të konstatuara, ku thuhet se rreth tre të katërtat e vendeve të OECD-së e kanë miratuar për zbatim kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara në raportet financiare të fund-vitit.

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik, i bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë, është një instrument kyç për qeveritë sepse:

- mundëson paraqitjen objektive, të krahasueshme dhe transparente të informacioneve financiare, përfshirë koston e veprimtarive shtetërore;
- mbulon plotësisht aktivitetet dhe detyrimet, si edhe të ardhurat dhe shpenzimet e një njësie ekonomike, përfshirë qeverinë si të tërë, duke ofruar në të njëjtën kohë informacion të plotë mbi flukset e mjeteve monetare;
- përfshin njohjen e ngjarjeve ekonomike si krijimi, transferimi ose shkatërrimi i vlerës ekonomike në momentin kur ndodhin;
- ofron një sërë përparësish në krahasim me kontabilitetin tradicional me bazë monetare, nga këndvështrimi i transparencës, llogaridhënies, menaxhimit financiar dhe realizimit të shërbimeve publike nga ana e qeverisë.

KONTABILITETI ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA NË SEKTORIN PUBLIK

Një instrument kyç për qeveritë



PULSAR

Programi PULSAR

administrohet nga:



CFRR >>>
Centre for Financial Reporting Reform



bashkëfinancohet nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

UDHËZUES I NIVELIT TË LARTË PËR PËRFITIMET E KONTABILITETIT ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA NË SEKTORIN PUBLIK



Një instrument kyç për qeveritë



PËRFITIMET NGA KONTABILITETI ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA NË SEKTORIN PUBLIK

LLOGARIDHËNIA



Informacion financiar i objektifikuar


Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara i mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira sistematizon politikat kontabël që përndryshe do të ishin jo të njëjta, mundëson paraqitjen e informacioneve financiare të krahasueshme dhe transparente dhe minimizon subjektivitetin dhe mungesën e transparencës në raportimin financiar.

Pjesëmarrje dhe përfshirje më e madhe politike

Informacionet e gjithanshme financiare mundësojnë debate më të informuara dhe gjithëpërfshirëse mbi ndikimin që ka politika buxhetore në jetën e shoqërisë civile. Kështu qytetarët fuqizohen për t'u angazhuar në diskutime të bazuara në dëshmi me përfaqësuesit e zgjedhur në nivel qendror, në lidhje me prioritetet e shpenzimeve publike, dhe për të kërkuar ndryshime të politikave bazuar në të dhëna të pakundërshtueshme.

Rritja e besimit të qeveria

Raportimi cilësor financiar mundëson mbikëqyrjen e jashtme të shpenzimeve publike, rritjen e besimit të qeverisja dhe përmirësimin e rezultateve të politikave. Është parë se transparenca dhe pjesëmarrja nxisin më shumë llogaridhënie lidhur me përdorimin e fondeve dhe mjeteve publike dhe ndihmojnë në parandalimin e korrupsionit duke ruajtur standarde të larta të integritetit.



TRANSPARENCA



Pamje e plotë e financave publike

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara prodhon një paketë më të plotë informacioni financiar, përtej thjesht flukseve monetare, dhe mundëson një perspektivë më afatgjatë të financave shtetërore. Njihen të gjitha aktivet dhe pasivet e sektorit publik, përfshirë aktivet financiare dhe jofinanciare, pasivet që nuk janë letra me vlerë të borxhit dhe obligacione, siç janë detyrimet e prapambetura dhe detyrimet për pensionet, si dhe shpenzime të tjera që përndryshe do të mbeteshin të fshehura, siç janë detyrimet e kushtëzuara.

Cilësi më e mirë e statistikave fiskale

Statistikat e financave shtetërore janë një mjet i rëndësishëm për hartimin e politikave dhe monitorimin e stabilitetit makroekonomik. Kur ke raporte financiare të audituara në nivel të njësisë ekonomike në bazë të standardeve të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara të zbatuara në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë sektorin publik dhe njësitë ekonomike të tij, ulet ndjeshëm riskun e gabimeve sistematike në të dhënat e përdorura për përgatitjen e statistikave fiskale.



PARAQITJE E VËRTETË DHE E DREJTË
Pamje e plotë dhe e besueshme e pozicionit financiar dhe ekonomik dhe performancës së qeverisë

PERFORMANCA



Përmirësimi i realizimit të shërbimeve publike

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara krijon lidhje të qartë midis shpërndarjes së burimeve dhe realizimit të shërbimeve, përmes sigurimit të informacionit se si janë mobilizuar burimet në dobi të qytetarëve. Përmirësimi i raportimit të informacioneve të sakta financiare nga njësitë e decentralizuara të realizimit të shërbimeve publike është i dobishëm për vlerësimin e performancës së qeverisë, zgjidhjen e pengesave dhe përmirësimin e cilësisë dhe shtrirjes së realizimit të shërbimeve publike.

MENAXHIMI FINANCIAR



Bazë e përmirësuar për marrjen e vendimeve

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik siguron një pamje të plotë të ecurisë financiare të qeverisë, koston së plotë të veprimtarive të qeverisë, informacione mbi detyrimet sociale dhe potencialin e ardhshëm për shërbime, duke siguruar planifikim më të saktë të nevojave imediate për fonde publike.

Përmirësimi i menaxhimit të riskut fiskal

Koncepti i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i cili i bën transparente detyrimet e ardhshme dhe pasivet e fshehura, u jep qeverive një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar dhe si edhe u tregon nëse ky pozicion është i qëndrueshëm dhe i menaxhueshëm.

Kthime më të larta mbi aktivet

Investimet publike krijojnë aktive, pasuri publike dhe vlerë ekonomike. Pasja e një informacioni të saktë për aktivet publike i jep mundësi qeverisë të kuptojë madhësinë dhe natyrën e tyre, gjë e cila sjell një menaxhim më efikas, përdorim më të synuar dhe kthim potencial më të madh mbi aktivet publike.